Njoftim publik

Në Komunën e Prishtinës është dorëzuar kërkesa 05 Nr.350/02-120885/26 dt.10.08.2026, në emër të aplikuesëve/bashkpronarëve Kastriot Vrella dhe Mehdi Begolli nga Prishtina, me Investitorë "Fehi Capital" sh.p.k., me nr. unik. Identifikues të biznesit 811581447, me seli në Prishtinë (Grupi i I-rë), dhe aplikuesëve/bashkpronarëve Çlirim Berisha, Elhame Berisha, Selatin Berisha, Isa Berisha nga Prishtina, me Investitorë "In On & HB Construction" sh.p.k., me nr. unik. Identifikues të biznesit 812045707, me seli në Prishtinë (Grupi i II-të), për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor, për ndërtimin e ndërtesave shumë banesore & afariste - **"Ndërtesa 1"** me -2B+P+11, **"Ndërtesa 2"** me -2B+P+9, në kuadër të Bllokut Urban **"B7"/ZSHP**, të Tërësisë Urbane **"B"**, të Planit Rregullues të Hollësishëm "Kalabria" 2024-2032 në Prishtinë, konkretisht në parcelat kadastrale nr. 7626-4, 7626-47, 7624-3, 7624-4, 7624-8, 7624-9 ZK Prishtinë.

Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **22.10.2026 deri më 05.11.2026**, në E-mail adresën: **urbanizmiprishtine@rks-gov.net.**

Kushtet e propozuara të ndërtimit:	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Ndërtesa shumë banesore & afariste-Ndërtesa
b. Vija rregulluese	Sipas planit rregullues
c. Vija ndërtimore	Sipas planit rregullues
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	sipas VN / ~ 40.5m', *sipas projekt propozimit*
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	~ 0.5 x H ose 0.25 sekondare (anësore) ~ 0.5 x H ose 0.25 sekondare (anësore) ~ 0.5 x H ose 0.25 sekondare (mbrapa)
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	0.3-0.4 e lejuar, sipas Planit rregullues ~ 1191.3m^2,~ 40%, *sipas projekt propozimit*
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	Sipas planit Bllokut me Koeficienti "B7"/2.4 ~ 8,328.85 m^2, *sipas projekt propozimit*
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40% e lejuar, sipas Vendimit të Kryetarit ~ 893.55+297.84m^2,~ 30+10%, *sipas projekt propozimit*
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	80% e lejuar sipas Planit rregullues ~ 2,382.78 m^2,~ 80% *sipas projekt propozimit*
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	96 VP, të brendshme & të jashtme, *sipas projekt propozimit*
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - ☒ Jo - ☐ Nuk aplikohet - ☐	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - ☐ Jo - ☒ Nuk aplikohet - ☐ Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigja njëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës.

Nënshkrimi i Zyrtarit: _____

Komuna e Prishtinës, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit
Adresa: rr. "Radovan Zogoviq" nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242 e-mail: urbanizmiprishtine@rks-gov.net